

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALB. TREN” Sh.p.k.**

Sot më datë 14 Qershor 2018,

- **Z. Edmond Pipero**, shtetas Shqiptar, i biri i Sulo, lindur në Vore, Tiranë, më 18.03.1971, banues në Vorë, Tiranë, mbajtës i pasaportes me Nr.BC1904467, Nr.personal H10318226U, dt.15.12.2009, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “ALB. TREN” sh.p.k.;**
- **Z. Miloš Kljajić**, shtetas Serb, i biri i Ljupko, lindur në Novi Sad, Kaç, Serbi, më 16.04.1983, banues në DR. MLADENA STOJANOVIĆA 069, NOVI SAD, KAĆ, Serbi, mbajtës i pashaportes me Nr.013358181, Nr.personal 1604983800048, dt.20.03.2018, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “ALB. TREN” sh.p.k.;**

kanë vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë “Shoqëria”), në bazë të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit“ (të ndryshuar) dhe ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (të ndryshuar).

Neni 1 - Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **“ALB. TREN” sh.p.k.**

Neni 2 - Selia

- 2.2 Selia e Shoqërisë është në Rr. **“Asim Vokshi”**, Pall.104, shk.2, Ap.36, Tiranë.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria është themeluar me dt. 14/06/2018. Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është e papërcaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të përcaktoj kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Shoqëria **“ALB. TREN” sh.p.k.**, ka si objekt veprimtarie:

- Ndërtim, studim, projektim mbikqyrje, supervizionim, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, rikonstruksione, vepra betonarmeje te vecanta, portuale, rrugore, kanalesh e kanalizime, hekurudhore e aeroportuale, vepra arti, rrugore, hekurudhore, hidraulike, tunele te impianteve te prodhimit dhe te shperndarjes se energjise, instalime dhe montimi i makinerive ngritese dhe transportuese, mirembajtje dhe sherbime te sistemit komunal, studime e projektme urbanistike, mirembajtje rutine rrugeshe e objekte te ndryshme ndertimi.
- Transporte e tregtim me shumice dhe pakice, karburantesh e mallrash te ndryshme, ushqimore, industriale, produkte bujqesore dhe blegtorale, minerale, hidrokarbure, çelik, qymyr, gaz, energji elektrike, mallra dhe paisje hekurudhore,

[Signature]

[Signature]

elektrike, elektromekanike, elektrtomjakesore, elektroshtepiake, hidrosanitare, makina e makineri, pjese kembimi, agregate, materiale ndertimi etj.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Z. Edmond Pipero**, shtetas Shqiptar, i biri i Sulo, lindur në Vore, Tiranë, më 18.03.1971, banues në Vorë, Tiranë, mbajtës i pasaportes me Nr.BC1904467, Nr.personal H10318226U, dt.15.12.2009, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “ALB. TREN” sh.p.k.;**
- **Z. Miloš Kljajić**, shtetas Serb, i biri i Ljupko, lindur në Novi Sad, Kaç, Serbi, më 16.04.1983, banues në DR. MLADENA STOJANOVIĆA 069, NOVI SAD, KAÇ, Serbi, mbajtës i pashaportes me Nr.013358181, Nr.personal 1604983800048, dt.20.03.2018, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **50 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “ALB. TREN” sh.p.k.;**

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 7.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administratori

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë personi i mëposhtëm:

Z. Edmond Pipero, shtetas Shqiptar, i biri i Sulo, lindur në Vore, Tiranë, më 18.03.1971, banues në Vorë, Tiranë, mbajtës i pasaportes me Nr.BC1904467, Nr.personal H10318226U, dt.15.12.2009, i cili ka të drejtë të ushtrijë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14 janar 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtar” (të ndryshuar).

- 8.2 Kohëzgjatja e detyrës së administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
- 8.3 Administratori i vetëm i Shoqërisë ka fuqi të kryej të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin normal të Shoqërisë me përjashtim të të drejtave që i janë njohur Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.5 Administratori i Shoqërisë është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkelje të ligjit, të këtij statuti, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

- 8.6 Shpërblimi që i jepet Administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Neni 9
Ndalimi i konkurrencës

- 9.1 Ortakët dhe administratorët e Shoqërisë nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në Shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë "ALB. TREN" sh.p.k. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
- 9.2 Ndalimi i sipër përmëndur shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posacëm, të dhënë nga ortakët, sipas dispozitave të nenit 36 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (të ndryshuar), apo nga Asambleja e Përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të po këtij ligji.
- 9.3 Ky ndalim mbetet në fuqi edhe për një periudhë një vjecare pas humbjes së cilësive apo statusit që administratori apo ortakët gëzojnë në Shoqëri.

Neni 10
Viti financiar

- 10.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 10.2 Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor 2018.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Akti Themelimi apo akteve të tjera të Shoqërisë, ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se ky nuk arrihet kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 12
Gjuha

- 12.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 14 Qershor 2018

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ALB. TREN" sh.p.k

Z.

Emri i sipërme
Emri i poshtme

Z.

Emri i sipërme
Emri i poshtme

Përkthyes
Erketa Xhung
elt

UK

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 669 Rep.



Tiranë, më: 14.06.2018

VËRTETIM

Sot më datën, 14.06.2018, para meje noteres, BLERTA KAÇELI, në Tiranë, me zyrë në rrugën "Myslym Shyri", Nr. 82, u paraqit personalisht:

Z. Edmond Pipero, shtetas Shqiptar, i biri i Sulo, lindur në Vore, Tiranë, më 18.03.1971, banues në Vorë, Tiranë, i njohur prej meje noteres prej pasaportes me Nr.BC1904467, Nr.personal H10318226U, dt.15.12.2009, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. Miloš Kljajić, shtetas Serb, i biri i Ljupko, lindur në Novi Sad, Kaç, Serbi, më 16.04.1983, banues në DR. MLADENA STOJANOVIĆA 069, NOVI SAD, KAÇ, Serbi, i njohur prej meje noteres prej pashaportes me Nr.013358181, Nr.personal 1604983800048, dt.20.03.2018, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

dhe nënshkruan me vullnet të lirë në prezencën time, Aktin e Themelimi të shoqërisë "ALB. TREN" sh.p.k., dt. 14.06.2018, pasi përmbajtja e tij iu përkthye Z. **Miloš Kljajić**, i cili me deklaroi se njih gjuhen angleze, nga gjuha shqipe në gjuhen angleze, prej përkthyeses Znj. Enkela Xhamaj, e bija e Ibrahim, lindur me dt. 24.05.1976, në Tiranë dhe banuese në Rr "Naim Frasheri", Pall. 60, Ap. 8, Tiranë, e njohur prej meje noteres prej leternjoftimit me nr. 024404761, datë 13. 02. 2009, me zotësi të plotë për të vepruar e cila zotëron gjuhen angleze dhe nënshkroi në prezencën time.

Une Noteria vërtetoj rregullsinë e nënshkrimit të tyre sipas Ligjit nr. 7829, dt.01.06.1994, "Per Noterine", në Republikën e Shqipërisë.

NOTERE
BLERTA KAÇELI

Blerta Kaçeli

